

RAPORT

“Hulumtim për matjen e kënaqshmërisë së konsumatorëve për gjithë zonën e shërbimit”

për periudhën Janar-Dhjetor 2022

Mars, 2023



IMPLEMENTUAR NGA :



D&D Business Support Center

Rr. Xheladin Hana, Iliria Building,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 (0) 38 748 701, +383 (0) 44 693 564
E-mail: info@dd-bsc.com
Web: www.dd-bsc.com

FINANCUAR NGA:



Bifurkacioni sh.a

K.R.U. "Bifurkacioni" SH.A

Rr. "Enver Topalli", nr.45
70000 Ferizaj, Republika e Kosovës
Tel: +381 (0) 290 320 650
Web: www.bifurkacioni.com

Përmbajtja

1. HYRJE	7
2. METODOLOGJIA	8
3. TË GJETURAT NGA HULUMTIMI	9
3.1. Shpërndarja e pyetësorëve në komuna dhe kategori	9
3.2. Kënaqshmëria e shërbimit të përgjithshëm të furnizimit me ujë të pijshëm.....	10
3.3. Kënaqshmëria e klientëve lidhur me shërbimet në de-blokimin e kanalizimit	11
3.4. Vlerësimi i performancës së inkasantëve gjatë realizimit të pagesave të shërbimeve.....	12
3.5. Vlerësimi i leximit të ujëmatësve dhe faturave të sakta	13
3.6. Vlerësimi rreth mundësive për llojet e pagesave të shërbimeve	14
3.7. Vlerësimi i punës në zyre rreth shërbimeve për konsumatorë	15
3.8. Vlerësimi rreth shërbimeve teknike, mirëmbajtës dhe intervenimit në rastet e paraqitjes së defekteve.....	16
3.9. Informimi rreth njoftimeve për ndërprerjen e shërbimeve të ujësjellësit.....	17
3.10. Pagesat rreth shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit	18
4. SEKTORI I AMVISERISË	19
4.1. Kënaqshmëria e shërbimit të përgjithshëm të furnizimit me ujë të pijshëm.....	19
4.2. Kënaqshmëria e klientëve lidhur me shërbimet në de-blokimin e kanalizimit	20
4.3. Vlerësimi i performancës së inkasantëve gjatë realizimit të pagesave të shërbimeve.....	21
4.4. Vlerësimi i leximit të ujëmatësve dhe faturave të sakta	22
4.5. Vlerësimi rreth mundësive për llojet e pagesave të shërbimeve	23
4.6. Vlerësimi i punës në zyre rreth shërbimeve për konsumatorë	24
4.7. Vlerësimi rreth shërbimeve teknike, mirëmbajtës dhe intervenimit në rastet e paraqitjes së defekteve.....	25
4.8. Informimi rreth njoftimeve për ndërprerjen e shërbimeve të ujësjellësit.....	26
4.9. Pagesat rreth shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit.....	27
5. KATEGORIA E BIZNESEVE	28
5.1. Kënaqshmëria e shërbimit të përgjithshëm të furnizimit me ujë të pijshëm.....	28
5.2. Kënaqshmëria e klientëve lidhur me shërbimet në de-blokimin e kanalizimit	29

5.3. Vlerësimi i përformancës së inkasantëve gjatë realizimit të pagesave të shërbimeve.....	30
5.4. Vlerësimi i leximit të ujëmatësve dhe faturave të sakta	31
5.5. Vlerësimi rreth mundësive për llojet e pagesave të shërbimeve	32
5.6. Vlerësimi i punës në zyre rreth shërbimeve për konsumatorë	33
5.7. Vlerësimi rreth shërbimeve teknike, mirëmbajtës dhe intervenimit në rastet e paraqitjes së defekteve.....	34
5.8. Informimi rreth njoftimeve për ndërprerjen e shërbimeve të ujësjellësit.....	35
5.9. Pagesat rreth shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit.....	36
6. KATEGORIA E INSTITUCIONEVE	37
6.1. Kënaqshmëria e shërbimit të përgjithshëm të furnizimit me ujë të pijshëm.....	37
6.2. Kënaqshmëria e klientëve lidhur me shërbimet në de-bllokimin e kanalizimit	38
6.3. Vlerësimi i përformancës së inkasantëve gjatë realizimit të pagesave të shërbimeve.....	39
6.4. Vlerësimi i leximit të ujëmatësve dhe faturave të sakta	40
6.5. Vlerësimi rreth mundësive për llojet e pagesave të shërbimeve	41
6.6. Vlerësimi i punës në zyre rreth shërbimeve për konsumatorë	42
6.7. Vlerësimi rreth shërbimeve teknike, mirëmbajtës dhe intervenimit në rastet e paraqitjes së defekteve.....	43
6.8. Informimi rreth njoftimeve për ndërprerjen e shërbimeve të ujësjellësit.....	44
6.9. Pagesat rreth shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit.....	45
7. KOMENTET NGA TË ANKETUARIT BAZUAR NË PYETJËN E 10 TË PYETËSORIT	46
8. KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET	47
9. ANEX 1 - PYETËSORI	49

Lista e tabelave

Tabela 1. Lloji i konsumatorit	9
Tabela 2. Kënaqshmëria e shërbimit të përgjithshëm të furnizimit me ujë të pijshëm	10
Tabela 3. Kënaqshmëria e klientëve lidhur me shërbimet në de-blokimin e kanalizimit	11
Tabela 4. Vlerësimi i performancës së inkasantëve gjatë realizimit të pagesave të shërbimeve	12
Tabela 5. Vlerësimi i leximit të ujëmatësve dhe faturave të sakta	13
Tabela 6. Vlerësimi rreth mundësive për llojet e pagesave të shërbimeve	14
Tabela 7. Vlerësimi i punës në zyre rreth shërbimeve për konsumatorë	15
Tabela 8. Vlerësimi rreth shërbimeve teknike, mirëmbajtës dhe intervenimit në rastet e paraqitjes së defekteve.....	16
Tabela 9. Informimi rreth njoftimeve për ndërprerjen e shërbimeve të ujësjellësit.....	17
Tabela 10. Pagesat rreth shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit.....	18
Tabela 11. Kënaqshmëria e shërbimit të përgjithshëm të furnizimit me ujë të pijshëm	19
Tabela 12. Kënaqshmëria e klientëve lidhur me shërbimet në de-blokimin e kanalizimit	20
Tabela 13. Vlerësimi i performancës së inkasantëve gjatë realizimit të pagesave të shërbimeve	21
Tabela 14. Vlerësimi i leximit të ujëmatësve dhe faturave të sakta	22
Tabela 15. Vlerësimi rreth mundësive për llojet e pagesave të shërbimeve	23
Tabela 16. Vlerësimi i punës në zyre rreth shërbimeve për konsumatorë	24
Tabela 17. Vlerësimi rreth shërbimeve teknike, mirëmbajtës dhe intervenimit në rastet e paraqitjes së defekteve.....	25
Tabela 18. Informimi rreth njoftimeve për ndërprerjen e shërbimeve të ujësjellësit.....	26
Tabela 19. Pagesat rreth shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit.....	27
Tabela 20. Kënaqshmëria e shërbimit të përgjithshëm të furnizimit me ujë të pijshëm	28
Tabela 21. Kënaqshmëria e klientëve lidhur me shërbimet në de-blokimin e kanalizimit	29
Tabela 22. Vlerësimi i performancës së inkasantëve gjatë realizimit të pagesave të shërbimeve	30
Tabela 23. Vlerësimi i leximit të ujëmatësve dhe faturave të sakta	31
Tabela 24. Vlerësimi rreth mundësive për llojet e pagesave të shërbimeve	32
Tabela 25. Vlerësimi i punës në zyre rreth shërbimeve për konsumatorë	33
Tabela 26. Vlerësimi rreth shërbimeve teknike, mirëmbajtës dhe intervenimit në rastet e paraqitjes së defekteve.....	34
Tabela 27. Informimi rreth njoftimeve për ndërprerjen e shërbimeve të ujësjellësit.....	35
Tabela 28. Pagesat rreth shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit.....	36
Tabela 29. Kënaqshmëria e shërbimit të përgjithshëm të furnizimit me ujë të pijshëm	37
Tabela 30. Kënaqshmëria e klientëve lidhur me shërbimet në de-blokimin e kanalizimit	38
Tabela 31. Vlerësimi i performancës së inkasantëve gjatë realizimit të pagesave të shërbimeve	39
Tabela 32. Vlerësimi i leximit të ujëmatësve dhe faturave të sakta	40
Tabela 33. Vlerësimi rreth mundësive për llojet e pagesave të shërbimeve	41
Tabela 34. Vlerësimi i punës në zyre rreth shërbimeve për konsumatorë	42
Tabela 35. Vlerësimi rreth shërbimeve teknike, mirëmbajtës dhe intervenimit në rastet e paraqitjes së defekteve.....	43
Tabela 36. Informimi rreth njoftimeve për ndërprerjen e shërbimeve të ujësjellësit.....	44
Tabela 37. Pagesat rreth shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit.....	45

Lista e figurave

Figura 1. Lloji i konsumatorit	9
Figura 2. Kënaqshmëria e shërbimit të përgjithshëm të furnizimit me ujë të pijshëm	10
Figura 3. Kënaqshmëria e klientëve lidhur me shërbimet në de-bllokimin e kanalizimit	11
Figura 4. Vlerësimi i performancës së inkasantëve gjatë realizimit të pagesave të shërbimeve	12
Figura 5. Vlerësimi i leximit të ujëmatësve dhe faturave të sakta	13
Figura 6. Vlerësimi rreth mundësive për llojet e pagesave të shërbimeve	14
Figura 7. Vlerësimi i punës në zyre rreth shërbimeve për konsumatorë	15
Figura 8. Vlerësimi rreth shërbimeve teknike, mirëmbajtës dhe intervenimit në rastet e paraqitjes së defekteve	16
Figura 9. Informimi rreth njoftimeve për ndërprerjen e shërbimeve të ujësjellësit	17
Figura 10. Pagesat rreth shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit	18
Figura 11. Kënaqshmëria e shërbimit të përgjithshëm të furnizimit me ujë të pijshëm	19
Figura 12. Kënaqshmëria e klientëve lidhur me shërbimet në de-bllokimin e kanalizimit	20
Figura 13. Vlerësimi i performancës së inkasantëve gjatë realizimit të pagesave të shërbimeve	21
Figura 14. Vlerësimi i leximit të ujëmatësve dhe faturave të sakta	22
Figura 15. Vlerësimi rreth mundësive për llojet e pagesave të shërbimeve	23
Figura 16. Vlerësimi i punës në zyre rreth shërbimeve për konsumatorë	24
Figura 17. Vlerësimi rreth shërbimeve teknike, mirëmbajtës dhe intervenimit në rastet e paraqitjes së defekteve	25
Figura 18. Informimi rreth njoftimeve për ndërprerjen e shërbimeve të ujësjellësit	26
Figura 19. Pagesat rreth shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit	27
Figura 20. Kënaqshmëria e shërbimit të përgjithshëm të furnizimit me ujë të pijshëm	28
Figura 21. Kënaqshmëria e klientëve lidhur me shërbimet në de-bllokimin e kanalizimit	29
Figura 22. Vlerësimi i performancës së inkasantëve gjatë realizimit të pagesave të shërbimeve	30
Figura 23. Vlerësimi i leximit të ujëmatësve dhe faturave të sakta	31
Figura 24. Vlerësimi rreth mundësive për llojet e pagesave të shërbimeve	32
Figura 25. Vlerësimi i punës në zyre rreth shërbimeve për konsumatorë	33
Figura 26. Vlerësimi rreth shërbimeve teknike, mirëmbajtës dhe intervenimit në rastet e paraqitjes së defekteve	34
Figura 27. Informimi rreth njoftimeve për ndërprerjen e shërbimeve të ujësjellësit	35
Figura 28. Pagesat rreth shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit	36
Figura 29. Kënaqshmëria e shërbimit të përgjithshëm të furnizimit me ujë të pijshëm	37
Figura 30. Kënaqshmëria e klientëve lidhur me shërbimet në de-bllokimin e kanalizimit	38
Figura 31. Vlerësimi i performancës së inkasantëve gjatë realizimit të pagesave të shërbimeve	39
Figura 32. Vlerësimi i leximit të ujëmatësve dhe faturave të sakta	40
Figura 33. Vlerësimi rreth mundësive për llojet e pagesave të shërbimeve	41
Figura 34. Vlerësimi i punës në zyre rreth shërbimeve për konsumatorë	42
Figura 35. Vlerësimi rreth shërbimeve teknike, mirëmbajtës dhe intervenimit në rastet e paraqitjes së defekteve	43
Figura 36. Informimi rreth njoftimeve për ndërprerjen e shërbimeve të ujësjellësit	44
Figura 37. Pagesat rreth shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit	45

1. HYRJE

K.R.U. "Bifurkacioni" SH.A është kompani regjionale e ujit dhe kanalizimit si ndërmarrje publike që ofron shërbimet e furnizimit me ujë të pijshëm dhe mbledhje të ujrave të zeza në pjesën jug-lindore të Kosovës. Prodhimi dhe shitja e ujit të pijshëm, mbledhja e ujërave të zeza dhe ujërave atmosferike janë aktivitetet kryesore të ndërmarrjes. Kjo kompani mbulon me shërbimet e saj komunën e Ferizajt, Kaçanikut dhe Hanit të Elezit.

D&D Business Support Center është kontraktuar nga K.R.U. "Bifurkacioni" SH.A. për realizimin e hulumtimit të kënaqshmërisë së konsumatorëve për periudhën Janar – Dhjetor 2022. Ky hulumtim ka për qëllim të pasqyroj opinionet e konsumatorëve për të vlerësuar gjendjen aktuale të kompanisë.

Të gjitha të dhënat e grumbulluara nga anketat e pranuar do të ndikojnë në përmirësimin e shërbimeve, duke i ofruar ato me cilësi më të lartë, të përballeshme ekonomikisht, përmirësim të performancës menaxheriale të kompanisë dhe duke i mundësuar qasje në shërbimet e ujësjellesit dhe kanalizimit.

Struktura e këtij hulumtimi është ndarë në 3 pjesë kryesore:

- * **Pjesa e parë:** përfshin qëllimin e hulumtimit, dhe detajet që ai përmban.
- * **Pjesa e dytë:** përfshin metodologjinë ku përshkruhen metodat të cilat janë përdorur tek mbledhja, analizimi, dhe komentimi i rezultateve të pranuar nga të anketuarit.
- * **Pjesa e tretë:** përfshin konkluzionin dhe rekomandimet për gjetjet kryesore të hulumtimit.

Përmes këtij hulumtimi, K.R.U. "Bifurkacioni" SH.A dhe palët e tjera të interesit do të njoftohen me qëndrimet e konsumatorëve rreth:

- * Cilësisë dhe furnizimit me ujë të pijes;
- * Shërbimit të trajtimit të ujërave të zeza (fekale);
- * Efikasitetit të KRU-së gjatë realizimit të kërkesave për dhënien e pëlqimeve për kyçjet në rrjetin e ujësjellesit dhe kanalizimit;
- * Efikasitetit të KRU-s gjatë leximit të ujëmatësve;
- * Përgatitjes së faturave të sakta për konsumin e ujit dhe pasqyrimin të pagesës për largimin e ujërave të ndotura (fekaleve), si dhe pastrimit të gypave të kanalizimit.
- * Efikasitetit të përgjithshëm të KRU-së rreth mundësive të pagesës së shërbimeve të ujit;
- * Vlerësimit për punën e qendrës (zyrës) për konsumatorë;
- * Vlerësimit të nivelit të informimit nga KRU-ja në lidhje me shërbimet, ndërprerjet e ujit për shkak të dëmtimeve në rrjetin e ujësjellesit;
- * Efikasitetit në shërbimet teknike të mirëmbajtjes për intervenimin në rrjetin e ujësjellesit dhe kanalizimit, në rastin e paraqitjes së defekteve, si dhe reagimit me kohë të KRU-së lidhur me shqetësimet dhe problemet e konsumatorëve.

2. METODOLOGJIA

Për realizimin e këtij hulumtimi është krijuar një pyetësor i cili ka mundur grumbullimin dhe analizimin e të dhënave statistikore dhe opinionet e ndryshme që mundësojnë krahasimin, identifikimin dhe vlerësimin e nevojave të konsumatorëve në raport me vitet e kaluara për ngritjen e kapacitetit të tyre në shërbime.

Pyetësori që kemi krijuar përmban 10 pyetje, i adresuar për 1,477 të intervistuar nga regjioni i Ferizajt, Kaçanikut dhe Hanit të Elezit që ndahen në 3 kategori siç janë:

- * Amvisëri - 1,227 anketime
- * Biznese - 227 anketime
- * Institucione - 23 anketime

Përfshirja e të anketuarve në këtë hulumtim është gjithëpërfshirëse, si në këndvështrimin gjeografik, demografik, social dhe sektorial. Përzgjedhja e mostrës është bërë sipas shpërndarjes demografike të popullsisë në komunat ku kompania të cilat u mbulon ndërmarrja publike K.R.U. “Bifurkacioni” SH.A.

Mbledhja e të dhënave është realizuar duke përdorur format elektronike (google form), përmes thirrjeve telefonike, publikimit në rrjete sociale, përmes adresave elektronike varësisht nga kërkesa e bizneseve dhe në terren (fizikisht) në komunat të cilat ky institucion i mbulon.

Ky pyetësor është ndarë në dy pjesë kryesore:

- * **Pjesa e parë** – përfshin të dhëna të përgjithshme si vendbanimi, zona e shërbimit dhe kategorisë që i takon (amvisëri, biznes ose institucion)
- * **Pjesa e dytë** – Përmban të dhëna të cilat kanë të bëjnë me kualitetin e furnizimit të ujit dhe largimit të ujrave të zeza, efikasitetin e zgjedhjes së ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve, tarifave, informimit të konsumatorëve për ndërprerje të ujit dhe shërbimet e ofruara nga zyra për konsumatorë. Ky hulumtim paraqet një rëndësi të veçantë në lidhje me shërbimet që ofron K.R.U “Bifurkacioni” SH.A. andaj të gjeturat e këtij pyetësori do të shërbejnë si udhërrëfyes përmes të cilit K.R.U.” Bifurkacioni” SH.A. mund të planifikoj rrjedhën e punës dhe përmirësoj shërbimet në rastet kur është e nevojshme.

Hulumtimi përfshin periudhën kohore Janar – Dhjetor 2022.

3. TË GJETURAT NGA HULUMTIMI

3.1. Shpërndarja e pyetësorëve në komuna dhe kategori

Kategoritë të cilat janë të përfshira në këtë hulumtim janë Amvisëritë, Bizneset dhe Institucionet, zonat e të cilave i mbulon K.R.U. "Bifurkacioni" SH.A.

Tabela 1. Lloji i konsumatorit


Qytet	Amvisëri	Biznese	Institucione	Totali
Ferizaj	1101	208	20	1329
	82.84%	15.65%	1.50%	89.98%
Kaçanik	120	17	2	139
	86.33%	12.23%	1.44%	9.41%
Hani i Elezit	6	2	1	9
	66.67%	22.22%	11.11%	0.61%
Total	1227	227	23	1477
	83.07%	15.37%	1.56%	100.00%

Komunat të cilat K.R.U. "Bifurkacioni" SH.A i mbulon duke i ofruar shërbimet e tyre, dhe duke u bazuar në numrin e përgjithshëm e të anketuarve, shpërndarjen e pyetësorve është klasifikuar në tre (3) sektorë të caktuar të cilat janë amvisëri, biznese dhe institucione. Në tabelën e mësipërme mund të vëreni se nga 1,477 të anketuar në komunën e Ferizajit janë përfshirë 1,329 ose 89.98% e të anketuarve, ku 208 ose 82.84% i përkasin kategorisë së amvisërisë, 208 ose 15.56% i përkasin kategorisë së bizneseve si dhe në kategorinë e institucioneve janë përfshirë 20 ose 1.50%.

Duke vazhduar me komunën tjetër që është Kaçaniku, nga 1,477 janë përfshirë 139 ose 9.41%, ku edhe në këtë komunë gjithashtu janë ndarë me kategori e që në amvisëri janë përfshirë 120 ose 86.33%, pastaj në kategorinë e bizneseve 17 ose 12.23% dhe në institucione 2 ose 1.44%.

Gjithashtu në komunën e Hanit të Elezit nga totali 1,477 kanë qenë të përfshirë 9 ose 0.61%, ku 6 ose 66.67% kanë qenë të përfshirë në kategorinë e amvisërisë, 2 ose 22.22% në kategorinë e biznesit si dhe sa i përket kategorisë së institucioneve 1 ose 11.11%.

Figura 1. Lloji i konsumatorit




3.2. Kënaqshmëria e shërbimit të përgjithshëm të furnizimit me ujë të pijshëm

Tabela 2. Kënaqshmëria e shërbimit të përgjithshëm të furnizimit me ujë të pijshëm

Qytet	Shumë të kënaqur	Deri diku i/e kënaqur	Pak i/e kënaqur	Aspak i/e kënaqur	Totali
Ferizaj	949	252	77	51	1329
	71.41%	18.96%	5.79%	3.84%	89.98%
Kaçanik	97	33	8	1	139
	69.78%	23.74%	5.76%	0.72%	9.41%
Hani i Elezit	7	2	0	0	9
	77.78%	22.22%	0.00%	0.00%	0.61%
Total	1053	287	85	52	1477
	71.29%	19.43%	5.75%	3.52%	100.00%

Tek pyetja e parë se sa janë të kënaqur të anketuarit e këtyre tri sektorëve (amvisëri, biznese dhe institucione) rreth shërbimit të përgjithshëm të furnizimit me ujë të pijshëm, nga totali 1,477 prej tyre 1,053 ose 71.29% janë shprehur si shumë të kënaqur, kurse mesatarisht të kënaqur kemi 287 ose 19.43%. Pjesa tjetër si më pak të kënaqur ka qenë 85 ose 5.75% të anketuar dhe pakënaqësitë e tyre me këto shërbime kanë shprehur 52 ose 3.52% të anketuar në këto sektore. Detajet e tjera janë të paraqitura edhe në tabelen e mësipërme të ndara edhe nëpër komuna, gjithashtu të paraqitura në grafe në figurën e mëposhtme.

Figura 2. Kënaqshmëria e shërbimit të përgjithshëm të furnizimit me ujë të pijshëm




3.3. Kënaqshmëria e klientëve lidhur me shërbimet në de-blokimin e kanalizimit

Tabela 3. Kënaqshmëria e klientëve lidhur me shërbimet në de-blokimin e kanalizimit

Qytet	Shumë të kënaqur	Deri diku i/e kënaqur	Pak i/e kënaqur	Aspak i/e kënaqur	Totali
Ferizaj	926	249	102	52	1329
	69.68%	18.74%	7.67%	3.91%	89.98%
Kaçanik	98	31	10	0	139
	70.50%	22.30%	7.19%	0.00%	9.41%
Hani i Elezit	8	1	0	0	9
	88.89%	11.11%	0.00%	0.00%	0.61%
Total	1032	281	112	52	1477
	69.87%	19.03%	7.58%	3.52%	100.00%

Bazuar në pyetjen se sa janë të kënaqur të anketuarit me shërbimet që ka ofruar kompania në de-blokimin e kanalizimit nga totali 1,477 prej tyre 1,032 ose 69.87% e të anketuarëve janë shprehur si shumë të kënaqur me këto shërbime, kurse deri diku të kënaqur kemi 281 apo 19.03% të anketuar. Më pak të kënaqur me këto shërbime janë shprehur 112 ose 7.58% dhe pakënaqësitë e tyre nga totali kanë shprehur 52 ose 3.52% e të intervistuarve.

Figura 3. Kënaqshmëria e klientëve lidhur me shërbimet në de-blokimin e kanalizimit




3.4. Vlerësimi i përfomancës së inkasantëve gjatë realizimit të pagesave të shërbimeve

Tabela 4. Vlerësimi i përfomancës së inkasantëve gjatë realizimit të pagesave të shërbimeve

Qytet	Shumë të kënaqur	Deri diku i/e kënaqur	Pak i/e kënaqur	Aspak i/e kënaqur	Totali
Ferizaj	934	252	98	45	1329
	70.28%	18.96%	7.37%	3.39%	89.98%
Kaçanik	100	28	10	1	139
	71.94%	20.14%	7.19%	0.72%	9.41%
Hani i Elezit	8	1	0	0	9
	88.89%	11.11%	0.00%	0.00%	0.61%
Total	1042	281	108	46	1477
	70.55%	19.03%	7.31%	3.11%	100.00%

Nga numri total i 1,477 e të anketuarëve të kategorisë së amvisërisë, bizneseve dhe institucioneve, 1,042 ose 70.55% prej tyre janë shprehur shumë të kënaqur me personelin gjatë realizimit të pagesave nga inkasantët në terren dhe arka, për shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit. Deri diku të kënaqur me këto shërbime kemi 281 ose 19.03% kurse më pak të kënaqur janë shprehur 108 ose 7.31%. Pjesa tjetër 46 ose 3.11% kanë shprehur paknaqësit e tyre rreth këtyre shërbimeve.

Figura 4. Vlerësimi i përfomancës së inkasantëve gjatë realizimit të pagesave të shërbimeve




3.5. Vlerësimi i leximit të ujëmatësve dhe faturave të sakta

Tabela 5. Vlerësimi i leximit të ujëmatësve dhe faturave të sakta

Qytet	Shumë të kënaqur	Deri diku i/e kënaqur	Pak i/e kënaqur	Aspak i/e kënaqur	Totali
Ferizaj	936	254	90	49	1329
	70.43%	19.11%	6.77%	3.69%	89.98%
Kaçanik	100	25	12	2	139
	71.94%	17.99%	8.63%	1.44%	9.41%
Hani i Elezit	7	2	0	0	9
	77.78%	22.22%	0.00%	0.00%	0.61%
Total	1043	281	102	51	1477
	70.62%	19.03%	6.91%	3.45%	100.00%

Në tabelën e mësipërme dhe grafikun e mëposhtëm janë paraqitur përgjigjet e të anketuarëve në lidhje me leximin e ujëmatësve. Nga totali 1,477 prej tyre 1,043 ose 70.62% janë shprehur si shumë të kënaqur me këto shërbime, kurse deri diku të kënaqur me këto shërbime janë shprehur 281 ose 19.03%. Pjesa tjetër si më pak të kënaqur ka qenë 102 ose 6.91% të anketuar dhe si të pakënaqur me këto shërbime kemi 51 apo 3.45% të anketuar.

Figura 5. Vlerësimi i leximit të ujëmatësve dhe faturave të sakta




3.6. Vlerësimi rreth mundësive për llojet e pagesave të shërbimeve

Tabela 6. Vlerësimi rreth mundësive për llojet e pagesave të shërbimeve

Qytet	Shumë të kënaqur	Deri diku i/e kënaqur	Pak i/e kënaqur	Aspak i/e kënaqur	Totali
Ferizaj	1036	195	56	42	1329
	77.95%	14.67%	4.21%	3.16%	89.98%
Kaçanik	106	25	7	1	139
	76.26%	17.99%	5.04%	0.72%	9.41%
Hani i Elezit	8	1	0	0	9
	88.89%	11.11%	0.00%	0.00%	0.61%
Total	1150	221	63	43	1477
	77.86%	14.96%	4.27%	2.91%	100.00%

Sa i përket pyetjes se sa janë të kënaqur të anketuarit rreth mundësive për pagesën e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga totali 1,477 prej tyre 1,150 janë shprehur shumë të kënaqur me këto shërbime, kurse deri diku të kënaqur janë shprehur 221 ose 14.96%. Më pak të kënaqur kemi 63 ose 4.27% të anketuar dhe si të pakënaqur me këto shërbime janë 43 apo 2.91% të anketuar. Të dhëna të detajuara mund ti shohim edhe përmes tabelës dhe figurës së paraqitur.

Figura 6. Vlerësimi rreth mundësive për llojet e pagesave të shërbimeve




3.7. Vlerësimi i punës në zyrë rreth shërbimeve për konsumatorë

Tabela 7. Vlerësimi i punës në zyrë rreth shërbimeve për konsumatorë

Qytet	Shumë të kënaqur	Deri diku i/e kënaqur	Aspak i/e kënaqur	Nuk kam kërkuar asnjëherë shërbim nga kjo zyrë	Totali
Ferizaj	828	242	107	152	1329
	62.30%	18.21%	8.05%	11.44%	89.98%
Kaçanik	91	22	4	22	139
	65.47%	15.83%	2.88%	15.83%	9.41%
Hani i Elezit	5	2	0	2	9
	55.56%	22.22%	0.00%	22.22%	0.61%
Total	924	266	111	176	1477
	62.56%	18.01%	7.52%	11.92%	100.00%

Pjesë e hulumtimit ka qenë edhe kënaqshmëria e klientëve lidhur me vlerësimin për punën e zyrës për konsumatorë për thirrje telefonike shqyrtimin, zgjedhjen e ankesave dhe mirëpritjen e stafit. Nga totali i të intervistuarve 1,477 prej tyre 924 ose 62.56% janë shprehur shumë të kënaqur me këto shërbime, kurse deri diku të kënaqur kemi 266 ose 18.01% të anketuar. Të pakënaqur me këto shërbime kemi 111 ose 7.52% të anketuar dhe pjesa tjetër 176 ose 11.92% kanë shprehur se nuk kanë kërkuar asnjëherë shërbim nga kjo zyrë.

Figura 7. Vlerësimi i punës në zyrë rreth shërbimeve për konsumatorë




3.8. Vlerësimi rreth shërbimeve teknike, mirëmbajtës dhe intervenimit në rastet e paraqitjes së defekteve

Tabela 8. Vlerësimi rreth shërbimeve teknike, mirëmbajtës dhe intervenimit në rastet e paraqitjes së defekteve

Qytet	Shumë të kënaqur	Deri diku i/e kënaqur	Pak i/e kënaqur	Aspak i/e kënaqur	Totali
Ferizaj	875	284	108	62	1329
	65.84%	21.37%	8.13%	4.67%	89.98%
Kaçanik	94	28	15	2	139
	67.63%	20.14%	10.79%	1.44%	9.41%
Hani i Elezit	6	3	0	0	9
	66.67%	33.33%	0.00%	0.00%	0.61%
Total	975	315	123	64	1477
	66.01%	21.33%	8.33%	4.33%	100.00%

Siç mund të shohim edhe në tabelën e mësipërme rreth kënaqshmërisë së shërbimeve teknike rreth mirëmbajtjes dhe intervenimit në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit në rastet e paraqitjes janë anketuar 1,477 persona, prej tyre 975 ose 66.01% janë shprehur shumë të kënaqur me këto shërbime, kurse deri diku të kënaqur kemi 315 ose 21.33% të anketuar. Si më pak të kënaqur me këto shërbime kemi 123 ose 8.33% dhe të pakënaqur gjithsej janë shprehur 64 ose 4.33% të anketuar.

Figura 8. Vlerësimi rreth shërbimeve teknike, mirëmbajtës dhe intervenimit në rastet e paraqitjes së defekteve




3.9. Informimi rreth njoftimeve për ndërprerjen e shërbimeve të ujësjellësit

Tabela 9. Informimi rreth njoftimeve për ndërprerjen e shërbimeve të ujësjellësit

Qytet	Njoftohem përmes TV lokal	Njoftohem përmes rrjeteve sociale (Facebook, Instagram)	Nuk njoftohem fare	Totali
Ferizaj	229	683	417	1329
	17.23%	51.39%	31.38%	89.98%
Kaçanik	0	73	66	139
	0.00%	52.52%	47.48%	9.41%
Hani i Elezit	1	6	2	9
	11.11%	66.67%	22.22%	0.61%
Total	230	762	485	1477
	15.57%	51.59%	32.84%	100.00%

Rreth pyetjes se si informohen të anketuarit për ndërprerjen e shërbimeve të ujësjellësit si pasojë e defekteve apo intervenimeve të planifikuara, nga totali 1,477 të anketuar prej tyre 230 ose 15.57% janë shprehur se njoftohen përmes TV lokal, pjesa tjetër 762 ose 51.59% kanë pohuar se njoftohen përmes rrjeteve sociale (Facebook, Instagram) dhe 485 ose 32.84% e të anketuarëve kanë shprehur se nuk njoftohen fare rreth këtyre shërbimeve.

Figura 9. Informimi rreth njoftimeve për ndërprerjen e shërbimeve të ujësjellësit




3.10. Pagesat rreth shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit

Tabela 10. Pagesat rreth shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit

Qytet	Shumë i rregullt	Deri diku i/e rregullt	Kohë pas kohe i/e rregullt	Aspak i/e rregullt	Totali
Ferizaj	958	272	59	40	1329
	72.08%	20.47%	4.44%	3.01%	89.98%
Kaçanik	102	23	11	3	139
	73.38%	16.55%	7.91%	2.16%	9.41%
Hani i Elezit	8	1	0	0	9
	88.89%	11.11%	0.00%	0.00%	0.61%
Total	1068	296	70	43	1477
	72.31%	20.04%	4.74%	2.91%	100.00%

Duke u bazuar në pyetjen se sa janë të rregullt gjatë pagesave të faturave për shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit kemi 1,477 të anketuar, prej tyre si shumë të rregullt me kryerjen e këtyre obligimeve kemi 1,068 ose 72.31%, kurse deri diku të rregullt janë shprehur 296 apo 20.04% të anketuar. Ata që kanë pohuar se këto obligime i paguajnë kohë pas kohe kanë qenë 70 ose 4.74% dhe si aspak të rregullt kemi 43 apo 2.91% të anketuar.

Figura 10. Pagesat rreth shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit



4. SEKTORI I AMVISERISË


4.1. Kënaqshmëria e shërbimit të përgjithshëm të furnizimit me ujë të pijshëm

Tabela 11. Kënaqshmëria e shërbimit të përgjithshëm të furnizimit me ujë të pijshëm

Qytet	Shumë të kënaqur	Deri diku i/e kënaqur	Pak i/e kënaqur	Aspak i/e kënaqur	Totali
Ferizaj	778	217	69	37	1101
	70.66%	19.71%	6.27%	3.36%	89.73%
Kaçanik	83	30	7	0	120
	69.17%	25.00%	5.83%	0.00%	9.78%
Hani i Elezit	5	1	0	0	6
	83.33%	16.67%	0.00%	0.00%	0.49%
Total	866	248	76	37	1227
	70.58%	20.21%	6.19%	3.02%	100.00%

Duke u bazuar në pyetjen e parë të këtij hulumtimi se sa janë të kënaqur të intervistuarit me cilësinë e shërbimit të përgjithshëm të furnizimit me ujë të pijshëm. Nga totali 1,227 si shumë të kënaqur në sektorin e amvisërisë kemi 866 ose 70.58%, kurse deri diku të kënaqur janë shprehur 248 ose 20.21%. Sa i përket pjesës tjetër pak të kënaqur kemi 76 ose 6.19% dhe si më pak të kënaqur nga totali 1227 kemi vetëm 37 ose 3.02% të anketuar.

Figura 11. Kënaqshmëria e shërbimit të përgjithshëm të furnizimit me ujë të pijshëm




4.2. Kënaqshmëria e klientëve lidhur me shërbimet në de-blokimin e kanalizimit

Tabela 12. Kënaqshmëria e klientëve lidhur me shërbimet në de-blokimin e kanalizimit

Qytet	Shumë të kënaqur	Deri diku i/e kënaqur	Pak i/e kënaqur	Aspak i/e kënaqur	Totali
Ferizaj	756	213	90	42	1101
	68.66%	19.35%	8.17%	3.81%	89.73%
Kaçanik	83	28	9	0	120
	69.17%	23.33%	7.50%	0.00%	9.78%
Hani i Elezit	5	1	0	0	6
	83.33%	16.67%	0.00%	0.00%	0.49%
Total	844	242	99	42	1227
	68.79%	19.72%	8.07%	3.42%	100.00%

Përgjigjet e pranura nga sektori i amvisërisë në pyetjen se sa janë të kënaqur të intervistuarit në shërbimet që ka ofruar kompania në de-blokimin e kanalizimit nga 1,227 në total prej tyre 844 ose 68.79% janë shprehur shumë të kënaqur, kurse mesatarisht të kënaqur kemi 242 ose 19.72%. Pjesa tjetër 99 ose 8.07% janë shprehur si më pak të kënaqur dhe të pakënaqur kemi 42 ose 3.42%. Të dhënat mund ti shohim edhe në tabelën e mësipërme të ndara në komuna dhe të paraqitura në grafe në figurën e mëposhtme.

Figura 12. Kënaqshmëria e klientëve lidhur me shërbimet në de-blokimin e kanalizimit




4.3. Vlerësimi i përformancës së inkasantëve gjatë realizimit të pagesave të shërbimeve

Tabela 13. Vlerësimi i përformancës së inkasantëve gjatë realizimit të pagesave të shërbimeve

Qytet	Shumë të kënaqur	Deri diku i/e kënaqur	Pak i/e kënaqur	Aspak i/e kënaqur	Totali
Ferizaj	756	218	91	36	1101
	68.66%	19.80%	8.27%	3.27%	89.73%
Kaçanik	86	24	9	1	120
	71.67%	20.00%	7.50%	0.83%	9.78%
Hani i Elezit	5	1	0	0	6
	83.33%	16.67%	0.00%	0.00%	0.49%
Total	847	243	100	37	1227
	69.03%	19.80%	8.15%	3.02%	100.00%

Nga totali 1,227 në sektorin e amvisërisë shumë të kënaqur janë ndarë 847 ose 69.03% të anketuar. Mesatarisht të kënaqur kemi 243 ose 19.80% kurse pjesa tjetër si më pak të kënaqur janë 100 ose 8.15% dhe të pakënaqur me këto shërbime kemi 37 ose 3.02% të anketuar.

Figura 13. Vlerësimi i përformancës së inkasantëve gjatë realizimit të pagesave të shërbimeve




4.4. Vlerësimi i leximit të ujëmatësve dhe faturave të sakta

Tabela 14. Vlerësimi i leximit të ujëmatësve dhe faturave të sakta

Qytet	Shumë të kënaqur	Deri diku i/e kënaqur	Pak i/e kënaqur	Aspak i/e kënaqur	Totali
Ferizaj	763	220	83	35	1101
	69.30%	19.98%	7.54%	3.18%	89.73%
Kaçanik	86	21	11	2	120
	71.67%	17.50%	9.17%	1.67%	9.78%
Hani i Elezit	5	1	0	0	6
	83.33%	16.67%	0.00%	0.00%	0.49%
Total	854	242	94	37	1227
	69.60%	19.72%	7.66%	3.02%	100.00%

Bazuar në tabelën e mësipërme nga 1,227 të anketuar në sektorin e amvisërisë prej tyre 854 ose 69.60% janë shprehur si shumë të kënaqur. Mesatarisht të kënaqur me leximin e ujëmatësve dhe përgatitjen e faturave të sakta lidhur me konsumin mujor janë shprehur 242 ose 19.72%. Pjesa tjetër si më pak të kënaqur janë shprehur 94 ose 7.66%, dhe si të pakënaqur me këto shërbime kemi 37 ose 3.02% të të anketuarëve në sektorin e amvisërisë.

Figura 14. Vlerësimi i leximit të ujëmatësve dhe faturave të sakta




4.5. Vlerësimi rreth mundësive për llojet e pagesave të shërbimeve

Tabela 15. Vlerësimi rreth mundësive për llojet e pagesave të shërbimeve

Qytet	Shumë të kënaqur	Deri diku i/e kënaqur	Pak i/e kënaqur	Aspak i/e kënaqur	Totali
Ferizaj	857	156	54	34	1101
	77.84%	14.17%	4.90%	3.09%	89.73%
Kaçanik	91	22	6	1	120
	75.83%	18.33%	5.00%	0.83%	9.78%
Hani i Elezit	5	1	0	0	6
	83.33%	16.67%	0.00%	0.00%	0.49%
Total	953	179	60	35	1227
	77.67%	14.59%	4.89%	2.85%	100.00%

Sa i përket kënaqshmërisë rreth mundësive për pagesën e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit nga 1,227 në total prej tyre 953 ose 77.67% e tyre janë shprehur shumë të kënaqur kurse pjesa tjetër si mesatarisht të kënaqur janë 179 ose 14.59%. Pak të kënaqur me këto shërbime kemi 60 ose 4.80% të anketuar dhe si të pakënaqur me këto shërbime kemi 35 ose 2.85% të anketuar.

Figura 15. Vlerësimi rreth mundësive për llojet e pagesave të shërbimeve




4.6. Vlerësimi i punës në zyre rreth shërbimeve për konsumatorë

Tabela 16. Vlerësimi i punës në zyre rreth shërbimeve për konsumatorë

Qytet	Shumë të kënaqur	Deri diku i/e kënaqur	Aspak i/e kënaqur	Nuk kam kërkuar asnjëherë shërbim nga kjo zyrë	Totali
Ferizaj	685	201	93	122	1101
	62.22%	18.26%	8.45%	11.08%	89.73%
Kaçanik	78	19	3	20	120
	65.00%	15.83%	2.50%	16.67%	9.78%
Hani i Elezit	4	2	0	0	6
	66.67%	33.33%	0.00%	0.00%	0.49%
Total	767	222	96	142	1227
	62.51%	18.09%	7.82%	11.57%	100.00%

Bazuar në përgjigjet e pranuar nga të anketuarit rreth vlerësimit të tyre për punën e zyrës për konsumatorë rreth thirrjeve telefonike, shqyrtimit dhe zgjidhjes së ankesave dhe mirëpritjen e stafit nga totali 1,227 prej tyre 767 ose 62.51% janë shprehur si shumë të kënaqur kurse mesatarisht të kënaqur janë shprehur 222 ose 18.09% dhe si të pakënaqur me këto shërbime kemi 96 ose 7.82% a të anketuarëve. Nga të anketuarit kemi edhe 142 ose 11.57% prej tyre që nuk kanë kërkuar asnjëherë shërbim nga zyret.

Figura 16. Vlerësimi i punës në zyre rreth shërbimeve për konsumatorë




4.7. Vlerësimi rreth shërbimeve teknike, mirëmbajtës dhe intervenimit në rastet e paraqitjes së defekteve

Tabela 17. Vlerësimi rreth shërbimeve teknike, mirëmbajtës dhe intervenimit në rastet e paraqitjes së defekteve

Qytet	Shumë të kënaqur	Deri diku i/e kënaqur	Pak i/e kënaqur	Aspak i/e kënaqur	Totali
Ferizaj	714	243	97	47	1101
	64.85%	22.07%	8.81%	4.27%	89.73%
Kaçanik	81	24	14	1	120
	67.50%	20.00%	11.67%	0.83%	9.78%
